



European Monitoring Centre
for Drugs and Drug Addiction



**Marrëveshje Pune
ndërmjet
Qendrës Evropiane Monitoruese për Drogat dhe Varësisë ndaj Drogave
dhe
Ministrit të Brendshme dhe Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Republikës së
Shqipërisë**

Ndërsa Qendra Evropiane Monitoruese për Drogat dhe Varësisë ndaj Drogave (EMCDDA) është një Agjenci e decentralizuar e Bashkimit Evropian e ngarkuar për të dhënë informacion faktik, objektiv, të besueshëm dhe të krahasueshëm në nivel Evropian, për sa i përket drogave, varësisë nga drogat dhe pasojave të tyre, në zbatim të kërkesave të përcaktuara në Rregulloren (EC) No 1920/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 12 dhjetor 2006 (i ndryshuar);

Ndërsa Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë (MB) është autoriteti kompetent për parandalimin dhe luftën kundër trafikut të paligjshëm, shpërndarjes dhe kultivimit të drogave;

Ndërsa Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë (MSHMS) është autoriteti kompetent në Shqipëri për të dhënë vlerësime epidemiologjike bazuar tek treguesit bazë të përdorur për të marrë informacion objektiv, të besueshëm dhe të krahasueshëm mbi përdorimin dhe varësinë ndaj drogave;

Ndërsa të dyja ministrat kanë shprehur interesin për të krijuar zyrtarisht një bashkëpunim të ngushtë dhe të vazhdueshëm me EMCDDA-në, me synim arritjen e një mirëkuptimi më të mirë, politikëbërje bazuar mbi prova dhe reagime për çështjet që lidhen me përdorimin e drogave;

Ndërsa në nenin 20 të Rregullores (EC) No 1920/2006 (i ndryshuar) specifikohet se Qendra duhet të përpiqet në mënyrë aktive për të bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare dhe organizma të tjerë, veçanërisht evropiane, qeveritare dhe jo-qeveritare, kompetente në sektorin e drogave dhe se ky bashkëpunim bazohet në marrëveshje pune që do të lidhen me këto organizma;

Ndërsa bordi i menaxhimit i EMCDDA-së, pas marrjes së opinionit pozitiv të Komisionit Evropian, i dha Drejtorit të EMCDDA-së në mbledhjen e datës 13–14 dhjetor 2018 autorizimin për të nënshkruar këtë marrëveshje pune;

Qendra Evropiane Monitoruese për Drogat dhe Varësisë ndaj Drogave dhe Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e Republikës së Shqipërisë, synojnë të bashkëpunojnë në fushat e mëposhtme:

- a) Shkëmbim i metodologjisë së sistemeve të mbledhjes së të dhënave dhe për të dhënat në veçanti (kërkesa dhe ulja e kërkesës, oferta dhe ulja e ofertës, aspektet ligjore dhe modelet e politikave);
- b) Shkëmbim i përvojave dhe të dhënave për substancat e reja psikoaktive (SRP), si dhe krijimi dhe forcimi i një Sistemi të Paralajmërimit të hershëm për Drogat;
- c) Shkëmbim i eksperiencave mbi reagimet shëndetësore dhe sociale ndaj problemeve të shkaktuara nga drogat, mbi të gjitha për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse, reduktimin e dëmit, integrimin social dhe kujdesin e integruar për personat që kanë varësi ndaj drogave.
- d) Mbështetje për përafrimin e legjislacionit kombëtar dhe politikave shqiptare me legjislacionin dhe politikat e BE-së mbi çështjet lidhur me drogat.

Vendi nënshkrimit: Vjenë

më 13 mars 2019

Për EMCDDA

Për Ministrinë e Brendshme
të Republikës së Shqipërisë

Për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes
Sociale të Republikës së Shqipërisë

Drejtori
Alexis Goosdeel

Zëvendësministri
Besfort Lamallari

Zëvendësministër
Mira Rakacolli